



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
REKTORATI

Nr. 211 prot

Korçë, më 31/01/ 2023

**THIRRJE PËR PROJEKTPROPOZIME PËR PROJEKTE TË KËRKIMIT
SHKENCOR TË FINANCUARA NGA
TË ARDHURAT E INSTITUCIONIT DHE NGA BUXHETI I SHTETIT
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", VITI 2023**

FOKUSI:

Universiteti "Fan S. Noli" shpall thirrjen për projektpropozime në fushën e kërkimit shkencor të financuara nga të ardhurat e institucionit dhe nga buxheti i shtetit, viti 2023

QËLLIMI

Thirrja shpallet në kuadër të nismës së Universitetit për planveprimin e përcaktuar në Objektivin 6 të Kërkimit shkencor në Planin Strategjik të Zhvillimit të Universitetit "Fan S. Noli" 2022-2027, duke synuar:

- rritjen e ndikimit të ekspertizës së specializuar të Universitetit në rajon në fushat e ekonomisë, bujqësisë, edukimit, teknologjisë së informacionit, shkencave humane, shkencave të natyrës dhe shkencave të shëndetit,
- vënien e kërkimit shkencor të aplikuar në dispozicion të zhvillimit rajonal,
- promovimin e këtij të fundit në një rrjet më të gjerë kërkuesish rajonalë/kombëtarë/ ndërkombëtarë,
- ofrimin e shërbimeve për palë të treta në rajon.

FINANCIMI

Financimi i përgjithshëm në dispozicion për këtë thirrje është **2.500.000 ALL**. Për projektet me kosto më të larta financiare se buxheti i parashikuar, njësitë duhet të sigurojnë bashkëfinancim nga burime të tjera të jashtme (kryesisht palë interesi në treg).

KOHËZGJATJA parashikohet **6-7 muaj** nga data e miratimit të projektit; afati përfundimtar dhjetor 2023

VEPRIMTARITË: shpenzime për aktive të qëndrueshme, për udhëtime dhe dieta, për pjesëmarrje në aktivitete shkencore dhe publikime, shpenzime përfaqësimi, transferime korrente me jashtë dhe shpenzime me jashtë, si dhe studime në terren, studime në

laborator, kërkime empirike kërkime në arkiva, aktivitete shkencore kuadër, botime, përmirësim infrastrukture kërkimore lidhur me sa më sipër, ekspertizë, rritje kapacitetesh të burimeve njerëzore në kërkim, (detajuar në Formularin e aplikimit : [Procedurat-per-projekte-te-financuara-nga-te-ardhurat-e-institucionit-1.pdf \(unkorce.edu.al\)](#))

APLIKUESIT

Koordinatori i projektit duhet të jetë specialist i fushës për të cilën hartohet projekti. Grupi i punës përfshin së paku 4 (katër) staf akademik/administrativ/ personel ndihmësakademik/studentë; në përbërje mund të ftohen edhe përfaqësues të palëve të interesit, apo institucioneve partnere.

KRITERE

1. Domethënia shkencore dhe qartësia e projektit
2. Ekspertiza e grupit të punës në lidhje me fushën e përzgjedhur
3. Partneriteti
4. Qëndrueshmëria e projektit
5. Menaxhimi buxhetor i parashikuar.

AFATET

- Projektpropozimet dorëzohen në format shkresor dhe Pdf pranë Zv/rektorit për Shkencën dhe Projektet (si dhe rektorati@unkorce.edu.al) deri në datën **3 mars 2023**.
- Rektorati organizon seancë trajnimi në lidhje me thirrjen dhe projekt-idetë në datën, **17 shkurt 2023**, ora 12:30, Auditori R28.
- Projektet fituese shpallen deri në **17 mars 2023**.
- Kohështrirja e veprimtarive të projektit parashikohen deri në dhjetor 2023.
- Raportimet mbi ecurinë e projektit hartohen dhe dorëzohen në mes dhe në fund të zbatimit të projektit.

FORMATI

- Projekti detajohet sipas Formularit I [Procedurat-per-projekte-te-financuara-nga-te-ardhurat-e-institucionit-1.pdf \(unkorce.edu.al\)](#)
- Raportimi periodik detajohet sipas Formularit II ([Procedurat-per-projekte-te-financuara-nga-te-ardhurat-e-institucionit-1.pdf \(unkorce.edu.al\)](#))

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT:

1. Kërkesë për aplikim e koordinorit të projektit, shoqëruar projektpropozimit.
2. Miratimi i Dekanit të fakultetit përkatës
3. Formulari i aplikimit të projektpropozimit (përfshirë planin e detajuar të veprimtarive dhe tabelat buxhetore)

